



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pratuar / Dërguar Prilgeno / Predato Received / Delivered	29 - 03 2023	3 viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shifra Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/STK	3027/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A . Nr.265/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës -Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga; Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Arben Mehmeti- anëtarë, dhe Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A. Nr. 265/2023 të datës 30.01.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A. Nr. 265/2023 e datës 30.01.2023, të parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në bazë të kontratës me numër KI.1000454962 dhe ripërtëritjes së kontratës të vitit 2018 në pozitën „Mbikëqyrës“ në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, me datë 30.01.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 1068/2023, kundër përgjigjes me numër protokolli 013 të datës 04.01.2023 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës gjegjësisht mënyrës se zëvendësimit të ankuesit nga pozita e deritanishme e Mbikëqyrësit të Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve në Pallatin e Drejtësisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 1473/2023

tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me datë 28.02.2023 dhe 08.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji i Këshillit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike dhe vendimmarrjes në mënyrë meritore ka kërkuar prova shtesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës lidhur me çështjen e lëndës, të cilat i ka pranuar me datë 21.03.2023 dhe protokolluar me numër 2844/2023.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.03.2023, ka nxjerr vendimin numër protokollit 2729/2023 për shtyrje të afatit edhe për 10 dhjetë ditë pune, lidhur me vendimmarrjen e ankesës së ankuesit

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 30.01.2023 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 20.12.2022 me numër protokollit 1361 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 04.01.2023; Ftesë për Aplikim i datës 27.10.2022 me numër protokollit 1103; Lista përfundimtare e kandidatëve që janë përzgjedh për pozitën Zyrtar korrektues dhe mbikëqyrës për NJPB e datës 02.12.2022 me numër protokollit 1266; E-mail i datës 14.12.2022 nga [] për [] etj; E-mail i datës 14.12.2022 nga [] për [] etj; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 07.02.2023 me numër protokollit 1473; E-mail i datës 28.02.2023 nga [] për []; Shkresa e Lëndës për ankesë e datës 28.02.2023 me numër protokollit 250; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 07.02.2023 me numër protokollit 1473; Akt Emërimi me AE.nr.102/2022 i datës 29.12.2022; Kontratë e punës për kohë të caktuar e datës 30.06.2018 Rekomandimi për përtëritjen e kontratës i datës 01.06.2018 Vendimi me numër protokollit 162 i datës 08.02.2023 i Zëvendëset të Drejtorit i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale lidhur me çështjen në procedurë, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Këshilli për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerëzore pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 27.10.2022 ka shpallur Ftesë për Aplikim me numër protokollit 1103 bazuar në Vendimin Nr.1101 të datës 27.10.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës ku theksohet se: *1."Të gjithë zyrtarët korrektues të cilët janë të inkuadruar në Njësinë për përcjelljen e të burgosurve, pas mbushjes së moshës 50 vjeçare lirohen nga detyrat dhe përgjegjësit e NJPB-së". 2."Zyrtarët të cilët kanë mbushur moshën e caktuar si në pikën I të këtij vendimi do të kthehen në detyrat e përcaktuara sipas kontratës së punës në institucionet Korrektuese përkatëse".*

Tutje bazuar në shkresat e lëndës Shërbimi Korrektues i Kosovës me datë 02.12.2022 ka shpallur Listën Përfundimtare me numër protokollit 1266 ku I.O është përzgjedhur Mbikëqyrëse, ndërsa ankuesi [] me datë 20.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1361 tek Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshme në Shërbimin Korrektues të Kosovës lidhur me zhvillimin procedurës së lëvizjes paralele të shpallur me datë 27.10.2022 të protokolluar me numër 1103, si dhe me mënyrën e zëvendësimit të ankuesit nga pozita e deritanishme e Mbikëqyrësit të Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve në Pallatin e Drejtësisë. Ndërsa Zëvendësuesi i Drejtorit i Përgjithshëm me përgjigjen në ankesë me numër protokollit 013 të datës 04.01.2023 thekson se Ftesa për

Aplikim është bazuar në Vendimin me nr.1101 të datës 27.10.2022 dhe se Zyrtarët Korrektues të cilët kalojnë në NJPB nuk kanë asnjë ndryshim të kontratave dhe vendi i tyre i punës nuk është i përhershëm referuar Rregullores së Brendshme të Punës për Përcjelljen e të Burgosurve të nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me nr.1439 të datë 30.11.2015, ku në pikën 2.7 nënpika 5 përcaktohet se stafi të cilët janë të inkuadruar në Njësitin për përcjellje të burgosurve nuk lejohen të ngarkohen me përgjegjësi pas mbushjes së moshës 50 vjeçare dhe gjithashtu duke inkurajuar ankuesin të vazhdoj të kryej detyrat dhe përgjegjësit sipas kontratës së lidhur me Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e trajtimit të kësaj ankese ju referua edhe Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 4 paragrafi 1, dhe 2 si dhe nën paragrafët nga 2.1 deri në 2.5, ku shprehimisht është e definuar "1.Nëpunësit profesionalë të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë; 2.Rregullimi me ligj të veçantë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm këto elemente të marrëdhënies së punës: 2.1 kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2 të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3 rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4 zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5 transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve", dhe mbi këtë bazë ligjore ka konstatuar se Vendimi i datës 27.10.2022 me nr.1101 i nxjerr nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Ftesa për Aplikim janë nxjerr në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës nenin 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10, ku Drejtoria e Përgjithshme e SHKK-së autorizohet të: "1.10. koordinojë funksionet administrative të SHKK-së, duke përfshirë por jo duke u kufizuar në menaxhimin e burimeve njerëzore, planifikimin e personelit, trajnimin dhe aftësimin e personelit të SHKK-së në mirëmbajtjen e të dhënave, sistemin e telekomunikimit, menaxhimin e buxhetit dhe të çështjeve financiare, prokurimin, inxhinieringun dhe logjistikën " dhe nenin 12 paragrafi 1.10 ku përcaktohet se " nxjerrë vendime, rregulla dhe procedura të brendshme për SHKK-në, të parapara me legjislacionin në fuqi" ndërsa ky vendim është në pajtim edhe me Rregullën e Brendshme të Punës për Njësitin për përcjelljen e të burgosurve i nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me nr.1439 datë 30.11.2015,ku në pikën 2.7 i referohet rregullave të standardit të sjelljes së stafit të NJPB-së, paragrafi 5 ku përcaktohet se: "Stafi i NJPB-së për nga mosha nuk lejohet të ngarkohet me këto përgjegjësi pas moshës 50 vjeçare, secili që mbushë këtë moshë do lirohet nga detyrat dhe përgjegjësitë në NJPB dhe kthehet në detyrat e mëhershme në institucionin përkatës".

Andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se Vendimi i datës 27.10.2022 me nr.1101 i nxjerr nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës referuar dispozitave që u potencuan si më lartë është në pajtim me këtë ligj dhe me ligjin e veçantë të këtij institucioni si dhe aktet nënligjore që derivojn nga ky ligji i veçantë, andaj Kolegji konstaton se ky vendim është nxjerr në pajtim legjislacionin në fuqi dhe se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara mbi këtë bazë të specifikuar më lartë sepse ankuesit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i cili është i përcaktuar në mënyrë specifike lidhur me marrëdhënien e tij të punës të përcaktuar sipas kontratës së punës me numër KI.1000454962 dhe ripërtëritjes

së kontratës të datës 01.06.2018, pasi që pozita dhe të drejtat që burojnë nga akti i përhershëm i themelimit të marrëdhënies së punës gjegjësisht paga nuk i janë cenuar andaj bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e pabazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A nr. 265/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Malsore GASHI - BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së,